



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.323/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e kandidatëve për anëtarë të kuvendit të Komunës së Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Iniciativa Demokracia, me seli në Deçan, Shefqet Demhasaj, Emine Hoxhaj, Flamur Avdimetaj, Smajl Neziraj, Nasret Delijaj, Rexhë Sadikaj, dhe Valmire Hajrizaj, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 25.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat të parashtruara nga kandidatët për anëtar në kuvendin e Komunës së Deçanit, Shefqet Demhasaj, Emine Hoxhaj, Flamur Avdimetaj, Smajl Neziraj, Nasret Delijaj, Rexhë Sadikaj, dhe Valmire Hajrizaj, nga subjekti politik Iniciativa Demokracia, me seli në Deçan, ZL. Anr.323/2025, ZL. Anr.324/2025, ZL. Anr.325/2025, ZL. Anr.326/2025, ZL. Anr.327/2025, ZL. Anr.328/2025, dhe ZL. Anr.329/2025, të datës 23.10.2025, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat nga subjekti politik Iniciativa Demokracia me seli në Deçan: me numër protokolli ZL. Anr.323/2025, ZL. Anr.324/2025, ZL. Anr.325/2025, ZL. Anr.326/2025, ZL. Anr.327/2025, ZL. Anr.328/2025 dhe ZL. Anr.329/2025, të parashtruara nga kandidatët për anëtar në kuvendin e komunës së Deçanit, Shefqet Demhasaj, Emine Hoxhaj, Flamur Avdimetaj, Smajl Neziraj, Nasret Delijaj, Rexhë Sadikaj, dhe Valmire Hajrizaj nga Subjekti Politik Iniciativa Demokracia, me seli në Deçan, në të cilat pretendojnë se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mungesë të votave të arritura me postë nga diaspora, ku me bindje të plotë theksojnë se kanë më shumë vota se sa janë publikuar nga KQZ-ja. Të njëjtit kërkojnë nga PZAP-ja që ankesat të aprovohen dhe të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve.

KQZ, në përgjigje në ankesë lidhur me pretendimet e palëve sqaron se sa i përket pretendimeve të palës për pikën e parë të ankesës, lidhur me çështjen e kërkesës për rinumërim të votave për vendvotimet nga komuna e Deçanit, njoftojnë se: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr.08/1.228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e

numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VII, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo IV. Në lidhje me pretendimet dhe kërkesën e palës ankuese për rinumërim të votave në vendvotimet nga Komuna e Deçanit, KQZ, pas analizimit të lëndës, ka konstatuar se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, pasi sipas konfirmimit të ZEKKZ-së në komunën e Deçanit, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur më datë 15.10.2025 në ora 15:00, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar më datë 23.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese për pikën e dytë të ankesës, lidhur me parregullsitë në numërimin e votave të votimit përmes postës, KQZ njofton se: Me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Më tej në përgjigje KQZ thekson se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, ka kontaktuar me KKZ e komunës së Deçanit, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: "Procesi i zgjedhjeve në Deçan ka qenë i rregullt dhe pa incidente, ndërsa procesi i numërimit në QKN-në në Deçan ka qenë i rregullt sipas dispozitave ligjore, nuk është hasur në ndonjë parregullsi apo mos përputhje të rezultateve me ditën e zgjedhjeve, edhe përkundër kësaj KKZ nëse ka vërejtur ndonjë parregullsi e ka shënuar në raportet e dorëzimit nga QKN në QNR, Procesi i numërimit në QKN në Deçan ka përfundua me datën 15.10.2025 në ora 15:00. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ju ka referuar asnjë qendër të votimit apo vendvotimit të caktuar, lidhur me shkeljet dhe parregullsitë e pretenduar në ankesë po ashtu nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet tij. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçantë; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankueshëm

nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL. Anr.323/2025ZL. Anr.324/2025, ZL. Anr.325/2025, ZL.Anr.326/2025, ZL. Anr.327/2025, ZL.Anr.328/2025 dhe ZL. Anr.329/2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.323/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, dhe përgjigjes në ankesë vëren se ankesat janë të pabazuara.

Paneli pas shqyrtimit të ankesave, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesat e parashtruara nga kandidatët për anëtar në kuvendin e komunës së Deçanit, Shefqet Demhasaj, Emine Hoxhaj, Flamur Avdimetaj, Smajl Neziraj, Nasret Delijaj, Rexhë Sadikaj, dhe Valmire Hajrizaj nga Subjekti Politik Iniciativa Demokracia, janë të pabazuara për faktin se të njëjtit nuk kanë arritur që të vërtetojnë, përkatësisht, të dëshmojnë faktin se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe mungesë të votave të tyre, nga familjarët e tyre si dhe nga diaspora, për të cilat palët ankuese pretendojnë në ankesat e tyre, kjo pasi që paraqitësit e ankesave nuk i kanë bashkangjitur asnjë provë të vetme për të provuar pretendimet e tyre. Sipas vlerësimit të panelit vetëm pretendimi nga ankesa se *“kemi vërejtur parregullsi gjatë rinumërimit-nuk dalin votat e mija të familjarëve si dhe votat e ardhura nga diaspora-nuk janë përfshirë apo janë përlogaritur gabimisht për subjektin tonë politik...”* e vlerëson si të pabazuar për faktin se parashtruesit e ankesave nuk ka mbështetur pretendimet e tyre me prova konkrete, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në kuptim, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Sa i përket pretendimeve të disa palëve ankuese që mbështetet në deklarinimin e disa të afërmeve dhe miqve të tyre, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, është përcaktuar se *“1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.”* Prandaj për këtë arsye nuk i mori si të bazuara, përkatësisht, nuk ia fali besimin pretendimeve të tilla me ankesë për të aprovuar ankesën si të bazuar.

Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja vëren se *“Sa i përket ankesës së kandidatëve nga subjekti politik Iniciativa Demokracia për parregullsi në QNR. Procesi i numërimit të votave në QNR, është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.14/2024,QNR ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem.”*

Prandaj, Paneli vlerësoi se ankesat e parashtruara ankuesit janë të pabazuara pasi që nuk kanë bashkangjitur prova që të dëshmojnë parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mungesave të

votave me postë, mbeten vetëm në suaza të dyshimit dhe se nuk janë mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesa nuk kanë arritur që të vërtetojnë pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.323/2025 datë 25.10.2025

Kryesues i Panelit
Hariz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.